



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Support Terreni PEI për zgjedhjet e pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Kukës, 24 Shtator 2023!

Për t'u përzgjedhur si support terreni për pajisjen elektronike të identifikimit elektronik të zgjedhësve nga KQZ, duhet të plotësosh kushtet dhe kriteret e mëposhtme:

1. Disponon makinë (kush i detyrueshëm);
2. Gëzon të drejtën për të qenë zgjedhës;
3. Nuk je i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen me dashje të një vepre penale;
4. Ke arsim të mesëm;
5. Nuk ke qenë anëtar i komisioneve zgjedhore dhe të grupeve të numërimit në dy proceset e fundit zgjedhore;
6. Nuk je anëtar i strukturave drejtuese të ndonjë partie politike, të paktën 3 vitet e fundit;
7. Nuk ke qenë i përfshirë publikisht në veprimtari politike dhe elektorale për llogari të një subjekti zgjedhor në 5 vitet e fundit;
8. Ke njohuri dhe aftësi minimale të përdorimit të pajisjeve të teknologjisë së informacionit, si kompjuter, smartphone, tablet, etj.;
9. Je i gatshëm për të punuar edhe larg vendbanimit;
10. Je me vendbanim në territorin e Bashkisë ku ndodhet qendra e votimit ku do të caktohesh nga KQZ;
11. Nuk je ushtarak, punonjës i strukturave të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Ministrisë së Brendshme, i Shërbimit Informativ Shtetëror, Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe shërbimeve të tjera me objekt veprimtarie të ngjashme me sa më sipër;
12. Nuk ndodhesh në kushtet e konfliktit të interesave;
13. Nuk je në marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të dytë ose marrëdhënie pune me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonën zgjedhore ku ndodhet qendra e votimit në të cilën operatori teknik është caktuar.

Detyrat e Supportit të Terrenit PEI:

1. Të diagnostiksh dhe te zgjidhe problematikat me Pajisjen Elektronike të Identifikimit të zgjedhësve në Zonen e Administrimit Zgjedhor në ditën e zgjedhjeve në 24 Shtator 2023, sipas udhëzimeve të KQZ;
2. Të diagnostikojë dhe te zgjidhe problematikat me kamerën vëzhguese në qendrën e votimit sipas udhëzimeve të KQZ;
3. **Masa e shpërblimit: 15,000 Lekë (bruto)**

Aplikantët do të përzgjidhen sipas Bashkisë ku kanë vendbanimin dhe do të trajnohen nga trajnues të kualifikuar.

Vlerësoje këtë mundësi punësimi edhe si kontribut qytetar për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor të datës **24 Shtator 2023!**

Afati i aplikimit: 15 Shtator 2023

Nxito të aplikosh! Koha dhe vendet janë të kufizuara!